

LIGJ
Nr.7750, datë 13.9.1993

PËR GRADAT NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë gradat u jepen oficerëve dhe nënoficerëve të shërbimit aktiv e rezervë, si dhe ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

Neni 2

Gradat ushtarake në Forcat e Armatosura janë:

Për oficerët		Forcat detare
a) Grada të ulëta,	nëntoger	(nënlejtant)
	toger	(lejtant)
b) Grada të mesme,	kapiten	(kapitenlejtant II)
	kapiten I	(kapitenlejtant I)
c) Grada të larta,	major	(kapiten i rangut III)
	nënkolonel	(kapiten i rangut II)
	kolonel	(kapiten i rangut I)
ç) Grada madhore,	gjeneral brigade	(kundëradmiral)
	gjeneralmajor	(nënadmiral)
	gjenerallejtant	(admiral)
	gjeneral	

Për nënoficerë (policë)

- Kapter	(polic)
- Kapter IV	(polic IV)
- Kapter III	(polic III)
- Kapter II	(polic II)
- Kapter I	(polic I)

Për ushtarët

- Tetar
- Rreshter
- Rreshter I

Neni 3

Gradën nëntoger e marrin oficerët që mbarojnë akademinë ose shkollat e larta ushtarake.

Ushtarakët që kryejnë studimet në akademitë ose shkollat ushtarake jashtë shtetit, në përfundim të tyre marrin gradë të barabartë me ushtarakët që mbarojnë studimet në akademi e shkolla të larta të njëjta me vendin tonë.

Ushtarakëve që dallohen për aftësi të veçanta gjatë shkollës dhe përfundojnë me rezultate shumë të mira, mund t'u jepet menjëherë grada e togerit.

Gradën kapter e marrin kursantët që mbarojnë shkollat e përgatitjes së nënoficerëve.

Neni 4

Koha e vjetërsisë për kërkimin e gradave të ushtarakëve është:

Për nënoficerët (policë)

- Nga kapter në kapter IV, 3 vjet
- Nga kapter IV në kapter III, 3 vjet
- Nga kapter III në kapter II, 4 vjet
- Nga kapter II në kapter I, 4 vjet.

Për ushtarët koha e gradimit dhe ndryshimet në gradë bëhen nga komanda ku ata shërbejnë.

Për oficerë

- Nga nëntoger (nënlejtant) në toger (lejtant), 2 vjet.
 - Nga toger (lejtant) në kapiten (kapitenlejtantII), 4 vjet.
 - Nga kapiten (kapitenlejtant II) në kapiten I (kapitenlejtant I), 4 vjet.
 - Nga kapiten I (kapitenlejtant I) në major (kapiten të rangut III), 5 vjet.
 - Nga major (kapiten të rangut III) në nënkolonel (kapiten të rangut II), 5 vjet.
 - nga nënkolonel (kapiten i rangut II) në kolonel (kapiten të rangut I), 5 vjet.
- Gradimi i kolonellëve në gjeneral dhe i gjeneralëve nuk lidhet me kohën e shërbimit të caktuar.

Neni 5

Gradat ushtarake madhore jepen me dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave. Në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë grada gjeneral brigade e lartë u jepet ushtarakëve që marrin funksione të caktuara në Forcat e Armatosura.

Neni 6

Për oficerët rezervistë gradat jepen, si rregull duke pasur për bazë kohën e vjetërsisë së shërbimit dhe funksionin që ata kryejnë.

Oficerëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë që kanë dalë në rezervë para rivendosjes së gradave, u jepet grada që i takon funksionit të fundit ushtarak që kanë pasur, me përjashtim të oficerëve që nuk kanë arsimin ushtarak përkatës.

Oficerët që rivishen ose që janë në rezervë dhe që kanë fituar statusin e të përndjekurit politik, u jepet grada e funksionit më të lartë ushtarak që kanë pasur.

Neni 7

Gradat ushtarake u jepen oficerëve me urdhër përkatësisht të ministrit të Mbrojtjes, ministrit të Rendit Publik dhe të kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar.

Gradat e nënoficerëve aktivë dhe rezervë, të ushtarëve dhe rezervistëve jepen nga komanda e divizionit, brigadës dhe komandat e kësaj shkalle.

Neni 8

Gradimi i oficerëve si rregull bëhet duke ndjekur rradhën e gradave.

Gradimi jashtë rradhe i oficerëve (me përjashtim të oficerëve madhorë), për merita të veçanta shërbimi ndaj atdheut, si dhe i atyre që dallohen për rezultate të larta në detyrat funksionale e në përgatitjen ushtarake në kohë paqeje e lufte, bëhet me urdhër, përkatësisht, të ministrit të Mbrojtjes, ministrit të Rendit Publik dhe kryetarit të SHIK-ut.

Neni 9

Ministri i Mbrojtjes, ministri i Rendit Publik dhe kryetari i SHIK-ut, për thyerje të rënda ose të përsëritura të disiplinës ushtarake dhe për paaftësi në detyrë kanë të drejtë t'ua ulin gradën oficerëve deri në një shkallë.

Gjeneralëve dhe admiralëve grada ushtarake u ulet me dekret të Presidentit të Republikës, në bazë të propozimit të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Oficerit dhe nënoficerit i lind e drejta për kërkimin e gradës tjetër, sipas rradhës, kur plotëson këto kushte:

- a) Mbush afatin e caktuar për kërkimin e gradës.
- b) Karakterizohet nga një disiplinë e lartë në shërbim.
- c) Plotëson kërkesat teorike dhe praktike për gradën që do të marrë.

Neni 11

Gradat nuk duhet të kalojnë kategorinë që ka ushtaraku në bazë të funksionit organik. Për specialistët e lartë që merren nga jeta civile, grada i jepet sipas funksionit organik përkatës të emërtimit në momentin e titullimit të tyre si oficerë.

Neni 12

Propozimi për dhënie grade ushtarakëve që mbarojnë akademitë ose shkollat e larta ushtarake, bëhet nga komanda e akademisë ose e shkollës së lartë ushtarake, kurse për oficerët nga komandanti i njësisë ku ai shërben.

Neni 13

Për gradimin e oficerëve e nënoficerëve në komandat e divizioneve, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Rendit Publik dhe në SHIK formohet një komision. Përbërja, funksionimi dhe numri i anëtarëve të komisionit caktohen me udhëzim të veçantë të ministrit ose titullarit përkatës.

Neni 14

Për çdo gradë ushtaraku i jepet shpërblim i veçantë që rritet nga grada në gradë në masën, që pëcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Oficerët që meritojnë gradimin por që nuk kanë vende të lira në gradën më të lartë, gjatë vitit të parë marrin gjysmën e shpërblimit të gradës që do të merrnin. Në vitin e dytë kur është e njëjta arsye mosgradimi, marrin shpërblimin e plotë të gradës që presin të gradohen, por jo më shumë se dy vjet.

Vjetërsia e shërbimit të oficerëve që meritojnë të gradohen, por që për arsyet e mësipërme nuk gradohen, u njihet vjetërsi për gradën që do të marrin sipas rradhës. Koha e luftës njihet dyfish për efekt gradimi për oficerët aktive e rezervistë që shërbejnë në njësitë, të cilat marrin pjesë në veprimet luftarake.

Neni 15

Dënimi me vendim gjyqi që sjell largimin nga detyra të oficerëve e nënoficerëve dhe kalimin e tyre në sektorin civil për më shumë se 6 muaj e shtyn 1 vit kohën e vjetërsisë së nevojshme për gradim.

Koha e paaftësisë së përkohshme deri në 6 muaj, e vërtetuar me raport mjekësor, njihet si vjetërsi për efekt gradimi. Vjetërsia e gradës për oficerët e nënoficerët llogaritet nga dita që ka dalë urdhri për gradimin e tyre.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

Forma, ndërtimi i secilës gradë dhe kriteret e veçanta për dhënien e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Grada e fituar në bazë të këtij ligji ruhet me lëvizjen e ushtarakut në një funksion organik më të ulët për arsye jo ushtarake.

Neni 17

Gradat që kanë fituar ushtarakët sipas ligjit nr.7499, datë 6.7.1991 "Për rivendosjen e gradave ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndryshojnë duke u rritur ose ulur në vartësi nga funksioni organik që ata kanë.

Neni 18

Oficerët në pension e gëzojnë të drejtën e mbajtjes së uniformës ushtarake të liridaljes, së bashku me gradën e fundit, që e veshin vetëm për raste festash zyrtare.

Neni 19

Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe SHIK-u, nxjerrin udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 20

Ligji nr.7499, datë 6.7.1991 "Për rivendosjen e gradave ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe ndryshimet që janë bërë me ligjin nr.7533, datë 17.12.1991 dhe me ligjin nr.7600, datë 8.9.1992, shfuqizohen.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.648, datë 24.9.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.